



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL
Datë 04.03.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:
Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Miratimi i kalendarit të veprimtarisë së Komisionit
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e privilegjeve dhe imuniteteve të autoritetit ndërkombëtar të shtratit të detit”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”.
5. Të tjera.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Namik Dokle, Ben Blushi, Valentina Leskaj, Olta Xhaçka, Përparim Spahiu, Eduard Selami, Kastriot Islami.

Mungojnë:

Aldo Bumçi, Gramoz Ruci, Jozefina Topalli, Gert Bogdani, Vangjel Dule, Shpëtim Idrizi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Z. Agim Bregasi, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Elektro-energjetik, MEI,
Znj. Aurora Alimadhi, Drejtoria Juridike, MEI

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade – Mirëmëngjes!! Në seancën plenare që kemi në radhë Komisioni për Politikën e Jashtme nuk ka ndonjë akt për të cilin do të jepte mendimin dhe kështu që aktet e sotme janë për datën 10 Mars.

Fillojmë mbledhjen e Komisionit me rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Miratimi i kalendarit të veprimtarisë së Komisionit
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e privilegjeve dhe imuniteteve të autoritetit ndërkombëtar të shtratit të detit”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”.
5. Të tjera.

Kemi të pranishëm përfaqësues të ministrive përkatëse.

Z. Ilirjan Mustafaraj, Zv. Ministër i Punëve të Brendshme

Z. Gentjan Jahjoli, Shef Sektori ne Drejtorinë e Marrëveshjeve, Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Artur Beu, Specialist ne Sektorin e Oficerëve Ndërlidhës dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit

Zj. Brunilda Koço, Drejtoria e Traktateve dhe së Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Jashtme;

Sipas rendit të ditës, e nisim me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar: keni vërejtje për procesverbalin? Miratohet? Miratohet!

Në kalendarin e punimeve të komisionit kemi deri në datën 21 mars vetëm tre akte për të kaluar. Dy do t'i shqyrtojmë sot dhe një mbetet për mbledhjen e datës 11.03.2014. Jeni dakord me kalendarin? Miratohet.

Sikurse e kemi bërë praktikë, për këto data të caktuara mund të kemi të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së jashtme për informacionet që ne i kemi kërkuar zyrtarisht dhe presim që të marrim përgjigje pozitive, gjithashtu dhe për kohën kur ata ta kenë të mundur të paraqiten në Komision.

Fillojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e privilegjeve dhe imuniteteve të autoritetit ndërkombëtar të shtratit të detit”. Fjalën e ka zonja Koço:

Brunilda Koço – Ministria e jashtme në këtë rast është institucioni inicues, propozues për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e privilegjeve dhe imuniteteve të autoritetit ndërkombëtar të

shtratit të detit. Ky Protokoll ka hyrë në fuqi në vitin 2003 anëtarë janë 36 vende. Ky propozim vjen pas kërkesave të vazhdueshme të Sekretariatit të Autoritetit Ndërkombëtar të Shtratit të Detit me seli në OKB që ne të bëhemi anëtarë në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa për Ligjin e Detit. Është sjellë si projektligj duke qenë se ky protokoll përmban imunitetet dhe privilegjet për anëtarët e autoritetit. Në qoftë se anëtarët e autoritetit do të vijnë të ushtrojnë funksionet e tyre gjatë kohës që janë në detyrë do të kërkojnë të njëjtat imunitete dhe privilegje siç gëzojnë diplomatët në rastet kur kryejnë detyrat e tyre në zbatim të Konventës së Vienës. Në fakt ky Protokoll për ata është një kuadër ligjor i cili i mbron për të ushtruar detyrat e tyre dhe përfituar imunitetin në atë shtet në të cilin ata kryejnë veprimtarinë. Cilat janë llojet e imuniteteve që ata mund të përfitojnë: imuniteti ndaj arrestimit ose ndalimit në lidhje me veprimet që do të kryejnë në kuadër të veprimtarisë që do të ushtrojnë, përjashtimi nga taksat mbi të ardhurat nga pagat, imuniteti ndaj detyrimeve të shërbimeve kombëtare, përjashtimi nga taksa dhe tatime të tjera, si dhe të drejtën për të transportuar pa paguar tarifatat doganore në rastin e ngarkesave të tyre personale.

Siç e thashë dhe më përpara janë 36 vende anëtare nga të cilat ato që kemi më afër janë Kroacia, Bullgaria, Italia, dhe Portugalia, Suedia, Hollanda, Britania e Madhe.

Autoriteti vepron në një zonë ekonomike e cila është pasuri e gjithë njerëzimit, ai është një institucion i ngritur pikërisht për të ruajtur këtë zonë. Për të kryer këtë funksion të tij zyrtar, Autoriteti ka nevojë dhe për këta privilegje nga shtetet. Në këtë kuadër dhe ne propozojmë aderimin në Protokoll. Kjo nuk sjell detyrime të menjëhershme, por nëse anëtarët e Autoritetit vijnë të ushtrojnë detyrën e tyre këtu ata janë të mbrojtur dhe gëzojnë imunitetet dhe privilegjet e tyre.

Arta Dade – Ka ndonjë pyetje për projektligjin nga deputetët? Ka ndonjë rol miratimi dhe ratifikimi i kësaj marrëveshjeje në lidhje me mosmarrëveshjet që lindin mes shteteve që kanë nënshkruar këtë Konventë?

Brunilda Koço – Jo. Ky është një autoritet ndërkombëtar i cili vepron për të mbrojtur zonën e cila është pasuri e të gjithë shteteve. Nuk ka të bëjë me shelfin kontinental. Është një detyrim që rrjedh nga fakti që jemi palë të Konventës së Detit.

Arta Dade – Faleminderit! A jeni dakord që t'i propozojmë seancës miratimin e marrëveshjes? Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL
Datë 04.03.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:
Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Eduard Selami, Gert Bogdani, Namik Dokle, Gramoz Ruci, Valentina Leskaj, Ben Blushi, Kastriot Islami.

Mungojnë:

Jozefina Topalli, Olta Xhaçka, Vangjel Dule, Shpëtim Idrizi, Përparim Spahiu, Fatmir Mediu.

Arta Dade – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”. Zoti Mustafaraj keni fjalën!

Ilir Mustafaraj – Faleminderit zonja Kryetare! Doja të informoja Komisionin e nderuar që deri tani kemi pasur një marrëveshje për bashkëpunimin në nivel strategjik me EUROPOL-in. Tani ne kalojmë në një hap të dytë, dhe në nivelin operacional, çka do të thotë që ne i hapim rrugë edhe hetimeve proaktive për çështje konkrete që lidhen me të gjithë llojet e krimeve që hetohen nga EUROPOL dhe çdo shtet anëtar. Doja të theksoj këtu që bashkëpunimi i deritanishëm ka qenë i tillë ku ne jemi palë e tretë, nuk jemi vend anëtar. Si i tillë mund të thuhet që është bashkëpunimi midis EUROPOL, SHBA, Kanadasë, Australisë, dhe një pjesë e vendeve të Ballkanit Perëndimorë, ku hyjnë Maqedonia dhe tashmë edhe ne. Serbia është në proces por nuk e ka arritur akoma.

Bashkëpunimi strategjik kishte të bënte me shkëmbim informacionesh të përgjithshme, në kuadrin e analizave për situatën e kriminalitetit, në fushën e narkotrafikut, terrorizmit, trafikeve njerëzore, e me radhë, të cilat janë përshkruar gjithashtu në marrëveshje.

Tashmë ne i hapim rrugë, pasi kemi plotësuar edhe kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit të klasifikuar që kemi në përdorim në sistem. Edhe çështje konkrete që lidhen me parandalimin, zbulimin dhe goditjen e krimit të organizuar në përgjithësi dhe në veçanti sipas rubrikave të ndryshme. Kjo është e reja e kësaj marrëveshjeje. Në krahasim me sektorët e tjerë ne bëjmë një hap përpara, pasi ne marrim pjesë afërsisht në kushtet e vendit kandidat, dhe shumë pak ndryshim do të ketë edhe kur të jemi vend

anëtar. Kemi një oficer kontakti sepse bashkëpunimi është që nga viti 2007, kemi një oficer kontakti tonë atje, nëpërmjet të cilit realizohet shkëmbimi i informacionit të përgjithshëm. Kemi kërkesa të vazhdueshme që të ratifikohet sa më shpejt për tu futur në çështje konkrete. Kjo është në vija të përgjithshme.

Arta Dade – Faleminderit! Ka ndonjë gjë për të shtuar nga përfaqësuesit e tjerë të ministrisë? Po pyetje nga deputetët? Urdhëroni zoti Dokle.

Namik Dokle – Unë kam një pyetje. Këtu flitet për trafikimin e paligjshëm të narkotikëve, trafikimi i mjeteve motorike, trafikimin e qenieve njerëzore. Po trafikimi i armëve nuk përfshihet në këtë marrëveshje? Ndoshta është në marrëveshje, por unë po shikoj relacionin.

Ilir Mustafaraj – Absolutisht që përfshihet, sepse e para është një çështje që ka lidhje me terrorizmin, është nga elementët e parë të kësaj figure të krimit. Këtu janë rrokur çështjet më të përgjithshme, mbase ka shpëtuar, sepse duhet të ishte dhe trafikimi i armëve.

Namik Dokle – Prandaj thashë që mbase duhet ta ketë marrëveshja por unë lexova relacionin dhe mu duk si një mungesë e çuditshme.

Arta Dade – Pyetje të tjera ka? Zoti Zëvendësministër, kjo marrëveshje a vepron për rastin e trafikimit të qenieve njerëzore brenda vendit, sepse dihet që kjo dukuri ka marrë disa tipare të reja tani. Përveç asaj që sigurisht ka rezultate të dukshme, kufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore drejt Evropës, tani kemi të dhëna që janë përfshirë dhe në raportet e Departamentit të Shtetit por dhe të organizmave të tjera që ky lloj trafikimi ka marrë disa tipare të reja: brenda vendit apo edhe në rajon. A bie kjo në fushën e veprimit të kësaj marrëveshjeje? Sepse ju e thatë që marrëveshje për shkëmbim informacioni ka pasur, por tani po kalojmë në veprimet operationale. A mundet Shqipëria të kërkojë mbështetje dhe ndihmë brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje dhe çfarë bëhet me vendet fqinjë Kosova, Serbia? Madje ka të dhëna që deri në Ukrainë ka shkëmbime për trafikim të qenieve njerëzore.

Ilir Mustafaraj – Sa herë që një veprimtari kriminale shtrihet në dy e më shumë vende është e vlefshme marrëveshja për të kërkuar edhe ndihmën dhe për të zhvilluar në mënyrë të përbashkët operationin e goditjes së kësaj veprimtarie. Dhe trafikimi i qenieve njerëzore është një prej elementeve që është rënë dakord për tu pasur si objekt veprimtarie. Por kemi dhe marrëveshje rajonale, sidomos me Kosovën e Malin e Zi, dhe ka një përvojë. Tashmë mendojmë që kjo luftë do të bëhet më efektive sepse do të kemi edhe ndihmën e partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Arta Dade – Edhe informacionet e fundit janë shumë shqetësuese. Në Britaninë e Madhe fëmijët e trafikuar nga Shqipëria konsiderohen të përbëjnë numrin më të madh. Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga marrëveshjet dypalëshe që mund të ketë, për zbulueshmërinë por dhe parandalimin cili është ndikimi?

Ilir Mustafaraj – Sigurisht që do të jetë më efektive dhe zbulueshmëria do të jetë më e lartë se tashmë do të kemi dhe ndihmë më të kualifikuar, edhe nga përvojat e vendeve evropiane por dhe nga përvoja e fituar në vite prej nesh për arsye se deri tani siç ju thashë ne shkëmbejmë informacion me EUROPOL-in por në kushtet e analizave, strategjive, dhe jo për çështje konkrete. Pra, duhet ratifikimi i kësaj marrëveshjeje që të hyjmë konkretisht në bashkëpunimin operacional, edhe për shkëmbim informacioni por edhe për ta goditur krimin me grupe të përbashkëta ekspertësh.

Arta Dade – A i keni strukturat e ngritura në lidhje me krimin kompjuterik?

Ilir Mustafaraj – Kemi.

Arta Dade – Me kapacitetet e nevojshme apo do të vazhdojë kualifikimi dhe rritja e profesionalizmit?

Ilir Mustafaraj – Kemi strukturën e ngritur, ka një përvojë disa vjeçare lufte në këtë fushë. Punohet për ta fuqizuar dhe ngritur kapacitetin, jo vetëm në drejtorinë e përgjithshme por edhe në drejtoritë e qarqeve, pasi po shohim një intensifikimi edhe të këtij lloji veprimtarie.

Valentina Leskaj – Desha të pyes nëse do të ketë element shtesë për sa i përket sigurisë të të dhënave? Sepse siguria e të dhënave është një çështje shumë e ndjeshme. Është një çështje që ka krijuar shumë probleme në vazhdimësi. Ne sigurisht nuk pretendojmë që me një marrëveshje të vetme me EUROPOL-in çdo gjë do të zgjidhet, por meqenëse ka pasur probleme me sigurinë e të dhënave, çfarë elementi të ri dhe garanci sjell kjo marrëveshje?

Ilir Mustafaraj – Siç ju thashë ne kemi një sistem komunikimi të certifikuar dhe nga ekspertët e EUROPOL-it, dhe pranohet që garanton besueshmëri dhe siguri të transmetimit të të dhënave. Kjo që thoni ju është drejtë dhe do të ketë dhe një memorandum mirëkuptimi për sa i përket besueshmërisë të të dhënave.

Arta Dade – Nëse nuk ka gjë tjetër, atëherë i falënderojmë zotërinjtë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A jeni dakord që marrëveshja të kalojë për shqyrtim në seancë plenarë? Pro? Kundër? Abstenim? Marrëveshja miratohet!

MBYLLET MBLEDHJA